



Datë: 02.09.2025
Numër Protokolli: 5984/2025

A.nr.1306/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1306/2025, të datës 07.07.2025, të parashtruar nga ankuesi, G.H, kundër organit të punësimit/ Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.09.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1306/2025, e datës 07.07.2025 e parashtruar nga ankuesi, G.H.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me nr.3550 i datës 19.06.2025 për kandidatin fitues nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në konkursin e shpallur me nr.reference RN00017975, Grupi i administrimit të përgjithshëm –Arsim i lartë, pozita Zyrtar i autorizimit të pagesave, klasa e pozitës, Profesional 2.

A r s y e t i m

Ankuesi, G.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 07.07.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4533/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1306/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference **RN00017975**, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 09.06.2025, nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, Grupi i administrimit të përgjithshëm –Arsim i lartë, pozita Zyrtar i autorizimit të pagesave, klasa e pozitës, Profesional 2, numri i kërkuar 1, për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 18.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 22.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me nr prot 4533/2025 të datës 07.07.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e ID-karteles të ankuesit; Formularët e Vlerësimit individual të kandidatit në intervistë dhe vlerësim të jetëshkrimit të datës 24.06.2025; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës 22.07.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Kopja e konkursit me nr.reference RN00017975; Arovimi i kërkesës për shpalljen e konkursit i datës 05.06.2025; Lista e Aplikantëve; rLista e kandidatëve të refuzuar; Lista e kandidatëve të aprovuar; Vendimi me numër protokolli 3461 të datës 17.06.2025 për formimin e Kmisionit të pranimit; E-mail i datës 23.06.2025; Njoftimi i datës 18.06.2025 për verifikimin paraprak; Njoftimi me nr.3550 të datës 19.06.2025 për kandidatin fitues; Akt Emër kandidatin G.H bashkë me dokumentacionin; rimi i datës 12.03.2024 për A.Q; Akt Emërimi i datës 12.03.2024 për E.B; Akt Emërimi i datës 26.11.2018 për Sh.M; Aplikacioni i datës 13.06.2025 për G.H bashkë me dokumentacionit; Aplikacioni i datës 15.06.2025 për V.V bashkë me dokumentacionin;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, më datë 09.06.2025 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00017975 me emrin e grupit, Grupi i administrimit të përgjithshëm –Arsim i Lartë, pozita “Zyrtar i autorizimit të pagesave”, për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme, me afat aplikimi nga data 10.06.2025 deri me datë 16.06.2025, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Nga shkresat e lëndës rezulton se sipas Njoftimit me numër protokolli 3550 të datës 19.06.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për listën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve të komisionit të pranimit, kandidatja fituese V.V ka marrë 90.67 pikë të përgjithshme ndërsa ankuesi është njoftuar se ka marrë 66.81 pikë të cilat nuk mjaftojnë për të kaluar prapen e kalueshmërisë.

Ankuesi me datë 07.07.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokolli 3550 të datës 19.06.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për listën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve të komisionit të pranimit, lidhur me konkursin me numër Reference RN00017975, Grupi i administrimit të përgjithshëm –Arsim i Lartë, pozita “Zyrtar i autorizimit të pagesave” i cili pretendon se moszgjedhja e tij është bërë në mënyrë të qëllimshme dhe diskriminuese duke kërkuar verifikim të bazës ligjore të këtij veprimi.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 22.07.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë duke njoftuar se konkursi ka qenë me kohë të caktuar për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme e që kohëzgjatja e emërimit është e caktuar deri më datë 27.05.2026 deri sa të kthehet zyrtarja B.H.B prej pushimit të lindjes.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00017975, Grupi i administrimit të përgjithshëm –Arsim i lartë, për pozitën “Zyrtar i autorizimit të pagesave” për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme e që kohëzgjatja e emërimit është për periudhë të caktuar derisa zyrtarja të kthehet nga pushimi i lehonisë deri më datën 27.05.2026, duke u bazuar në nenin 37 paragrafi 2,3 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për

Zyrtaret Publik ku përcaktohet se: “ Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj. 3. Përfundimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 3.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 4. Kontrata e punës për periudhë të caktuar sipas paragrafit 3. të këtij neni, lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.1. të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.2. të këtij neni”, dhe Rregullores (QRK) nr. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, ku arsyeja e plotësimit të kësaj pozite është në rast të mungesës së përkohshme e që kohëzgjatja e emërimit është dy(2) vite në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, ku kërkesat e përgjithshme formale në këtë konkurs kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor).Grupi i administrimit të Përgjithshëm, **Kërkesat specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase, **Përvoja e punës së kërkuar:** Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Kolegji i Këshillit, duke e shqyrtuar Njoftimin e datës 19.06.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, konstaton se në bazë të dosjes së dërguar nga organi përkatës i punësimit, kandidatja fituese me 90.67 pikë të përgjithshme me rastin e aplikimit të datës 15.06.2025 ka ofruar këto dokumente: Diplomën e datës 30.10.2020 me nr.1320 të lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe mori titullin Bachelori i Teknologjisë Ushqimore me Bioteknologji; Diplomen Master në Shkencën e ushqimit të datës 17.09.2024 të lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Dëshmia nga Agjencia Pyjore e Kosovës se kandidatja fituese V.V ka kryer paraktiken prej datës 05.04.2023 deri më 04.04.2024, letër reference e datës 13.06.2025 ku vërtetohet se e njëjta nga data 01.11.2024 është në marrëdhënie pune në AZHB ku vazhdon edhe tani Zyrtare për autorizim të pagesave në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, konstaton se nga faktet e prezantuara, rezulton se Njoftimi i datës 19.06.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për kandidatin fitues, është nxjerr në pajtim me nenin 37 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe neni 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe neni 12 i Rregullores (QRK) nr. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar ku përcaktohet se: “1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme, për rastet si në vijim: 1.1. pushimit mjekësor pa pagesë; 1.2. pushimit të lehonisë; 1.3. ndjekjes së ndonjë trajnimit apo programi profesional në emër të institucionit; 1.4. transferimit të përkohshëm në detyra të tjera brenda apo jashtë vendit; 1.5. pezullimit sipas neneve 69 dhe 70 të LZP-së; 1.6. në raste të tjera të mungesës së përkohshme nga puna të përcaktuara me LZP. 2. Themelimi i marrëdhënies së punës me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme mund të bëhet vetëm kur nëpunësi civil mungon për arsye sipas paragrafit 1 të këtij neni, së paku tre (3) muaj” dhe neni 12 i kësaj Rregulloreje Ku përcaktohet se: Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i intervistës dhe jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve. 2. Pas përfundimit të intervistës dhe vlerësimit të jetëshkrimit, Komisioni i Përzgjedhjes përgatit listën përfundimtare të cilën e përcjellë tek NjMBNj në të cilën shënohet emri dhe mbiemri i kandidatit si dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat. 3. Lista publikohet në SIMBNj, në ueb faqen e institucionit dhe mjete të tjera të përshtatshme për informim. 4. Kandidati që merr më së shumti pikë por jo më pak se pragu prej shtatëdhjetë (70) pikëve, konsiderohet kandidat fitues”. ”, andaj duke u nisur nga fakti se kandidatja fituese i ka plotësuar

kriteret e përgjithshme formale të konkursit Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Andaj për sa më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1306/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit G.H;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.